



Pranuar / Dorezuar Prinjenos/Prodato Received/Delivety	29.12.2021	viti god. year	1
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHOK	6348/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.965/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.965/2021 të datës 24.11.2021 e parashtruar nga ankuesi [] të cilin e përfaqëson me autorizim Avokat [] me adresë Rruga "Fehmi Agani", Kati 1, Nr.8, Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet ankesa e parashtruar nga ankuesi [] me numër A.nr.965/2021 e datës 24.11.2021.

A r s y e t i m

Ankuesi [] i punësuar sipas Akt emërimit me numër të protokollit 90/2016 të datës 03.10.2016 në vendin e punës "Drejtor i Departamentit të SPIMNQ" në Departamentin DSPIMNQ, me datë 18.11.2021 me numër 1253 Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme paraqet kërkesën për inicim të procedurës disiplinore, me arsyetim për mos përmbushje të detyrave të punës, mosrespektimin e afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale si dhe shkelja e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit [] me datë 19.11.2021 me numër 1259/2021 merr vendim për pezullim nga detyra të ankuesit [] ankuesi i pa kënaqur me këtë vendim nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokat [] me datë 24.11.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 5651/2021, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme me numër të protokollit 1259/2021 të datës 19.11.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.12.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Më datë 08.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruara këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 24.11.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi për përfaqësim i datës 22.11.2021; Akt emërimi i datës 03.10.2016; Vendimi i datës 19.11.2021 i Komisionit Disiplinor; Kërkesa për inicim të procedurës datës 18.11.2021; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendimi i datës 17.11.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Procesverbali i datës 19.11.2021 i Komisionit Disiplinor; Kontrata me nr.214-21-6569-2-1-1/C119; Kërkesa e datës 16.09.2021 për përshpejtimin e procedurave për Mirëmbajtjen Higjenike të Kompleksit Rilindja; Ri-kërkesa për inicim të procedurave të prokurimit e datës 16.07.2021; Kërkesë për përshpejtim të procedurave e datës 16.09.2021; E-mal-at e datave 17.11.2021, 16.11.2021, 15.11.2021, 11.11.2021; Raport i Auditimit "Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit nga DSPIMNQ 2016/2018"; Raporti i Auditimit të Performancës "Menaxhimi i kontratave publike ndërtimit"; e-mal-at e datave 09.11.2021, 14.09.2021, 27.10.2021, 21.10.2021, 07.10.2021, 24.09.2021, 22.09.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se është plotësuar kushtet ligjore që ankesa e ankuesit të pezullohet deri në marrjen e vendimit merititor nga ana e Komisionit Disiplinor, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme vendimin me numër 1259/2021 të datës 19.11.2021 e ka nxjerrë duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenin 48 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar"*, po ashtu edhe me nenin 13 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ka përcaktuar se Komisioni Disiplinor mund të vendos edhe pezullimin e marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, nëse vlerëson se nëpunësi civil ndaj të cilit zhvillohet procedura disiplinore pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij.

Po ashtu me dispozitat ligjore të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar edhe *"pezullimi i procedurës"*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar që është përmbushur kushti ligjor që të pezullohet ankesa e ankuesit e datës 24.11.2021 me

numër të protokollit 5651/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A.nr.965/2021

Valentina KAÇANDOLLI BEKTESHI


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avoka
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe
- Arkivot të Këshillit.

